

Golden Eagle sh.p.k.
Raporti i audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8-26

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Ortakëve dhe Drejtuesve të Shoqërisë Golden Eagle Sh.p.k.

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Golden Eagle sh.p.k. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018 dhe pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare më dhe për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të përshkruara në seksionin *Bazat për Opinionin me rezervë*, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

Bazat për Opinionin me rezervë

Mos pjesëmarrje në numërimin e inventarit

Ne u përcaktuam si auditues të shoqërisë në mars të vitit 2019 dhe për këtë arsye nuk kemi pasur mundësinë të vëzhgonim numërimin e inventarit fizik në fillim të vitit. Ne nuk mundëm të merrnim evidenca nga procedura alternative në lidhje me gjëndjen e inventarit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Meqenëse teprica celjes së inventarit ndikon në performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare, nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse rregullimet ishin të nevojshme në lidhje me fitimin e vitit të raportuar në pasqyrën e performancës financiare dhe të fluksit neto të mjeteve monetare nga aktivitetet operative të raportuara në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare.

Kapitali i matur me koston historike

Sic është paraqitur në shënimin shpjegues 12 të pasqyrave financiare, kapitali ka vlerën 532,936,250 lekë (2017: 532,936,250 lekë) ku kapitali është paguar në dollarë amerikanë dhe është matur me kursin e këmbimit prej 94.325 ALL/USD. Sipas Standartit Kombëtar të Kontabilitetit "1", kapitali i paraqitur në monedhë të huaj, duhet të mbahet me koston historike. Shoqëria nuk siguroi evidencë të mjaftueshme dhe të përshatshme auditimi në lidhje me koston historike. Rrjedhimisht, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse ishin të nevojshme rregullimet e këtyre shumave.

Paragraf për çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pa modifikuar mbi këto pasqyra financiare më 28 mars 2018.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (Vazhdim)

Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Deloitte Audit Albania sh.p.k



Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera,
Tiranë, Shqipëri

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara
Auditues ligjor
Partner Angazhimi

Tiranë, Shqipëri
12 qershor 2019

GOLDEN EAGLE SH.P.K
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Aktivitet			
Aktivitet Afatshkurtra			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	4	240,829	117,808
Inventari	5	15,938	15,833
Të arkëtueshme tregtare	6	18,219	30,878
Tatim fitimi i parapaguar		159	-
Shpenzime të parapaguara	7	2,538	2,906
Totali i aktiveve afatshkurtra		277,683	167,425
Aktivitet Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	1,225,221	1,290,391
Aktive afatgjata jo-materiale		2,226	2,967
Totali i aktiveve afatgjata		1,227,447	1,293,358
Totali i aktiveve		1,505,130	1,460,783
Detyrime			
Detyrime Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	9	66,287	71,823
Të pagueshme të tjera	10	45,028	39,317
Tatim fitimi i pagueshëm		-	985
Totali i detyrimeve afatshkurtra		111,316	112,125
Detyrime Afatgjata			
Depozita-Garanci për qiratë	11	4,221	5,981
Totali i detyrimeve afatgjata		4,221	5,981
Totali i detyrimeve		115,536	118,106
Kapitali			
Kapitali i paguar	12	532,936	532,936
Rezerva ligjore	12	20,286	20,286
Rezerva të tjera	12	21,046	21,046
Fitimi i pashpërndarë	12	765,796	716,278
Fitimi i vitit	12	49,530	52,131
Totali i kapitalit		1,389,594	1,342,677
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,505,130	1,460,783

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 8 deri më 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

GOLDEN EAGLE SH.P.K**Pasqyra e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura			
Të ardhura nga shitjet	13	666,114	629,836
Të ardhura te tjera	14	4,865	4,558
Të ardhura bruto		670,979	634,394
Shpenzime			
Ndryshime në gjendje inventari	15	(90,486)	(85,127)
Shpenzime personeli	16	(161,246)	(146,196)
Shpenzime operative	17	(163,521)	(147,006)
Tarifa menaxhimi	18	(76,569)	(72,244)
Shpenzime të tjera	19	(20,166)	(19,270)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	8	(89,424)	(95,335)
Totali i shpenzimeve		(601,413)	(565,178)
Fitimi nga aktiviteti operativ		69,566	69,216
Kostot financiare neto			
Shpenzime financiare neto	20	(7,750)	7,726
Fitimi neto nga kursi i këmbimit	20	448	(3,305)
Shpenzimet financiare neto		(7,302)	4,421
Fitimi para tatimit		62,264	64,795
Shpenzime për tatim fitimin	21	(12,735)	(12,664)
Fitimi neto i vitit		49,530	52,131
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		49,530	52,131

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 8 deri më 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

GOLDEN EAGLE SH.P.K


Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

	Kapitali i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Teprica më 1 janar 2017	532,936	20,286	21,046	716,278	1,290,547
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirë të vitit	-	-	-	52,131	52,131
Teprica më 31 dhjetor 2017	532,936	20,286	21,046	768,409	1,342,677
Teprica më 31 dhjetor 2017	532,936	20,286	21,046	768,409	1,342,677
Korrigjime ne shpenzimet e zhyresimit te pajisjeve te zyles nga vitet e kaluara	-	-	-	(2,613)	(2,613)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirë të vitit	-	-	-	49,530	49,530
Teprica më 31 dhjetor 2018	532,936	20,286	21,046	815,326	1,389,594

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Drejtimi më 6 qershor 2019 dhe janë firmosur nga:

Rudolf Schmitz
Administrator



Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet nga fagja 8 deri më 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Regjistr H. J. etel Tirana
Golden Eagle sh.p.k - Accounting
Elvdi. Deshmoret e Kombit, AL - 1000 Tirana
Tel.: +355 4 2235035

Manjola Malo
Shefe kontabiliteti



GOLDEN EAGLE SH.P.K

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	49,530	52,131
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	89,425	95,335
Zbritje nga llogaria e arkëtueshme	2,080	728
Zvogëlimi i fitimeve të pashpërndara	(2,613)	-
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	10,579	32,271
(Rritje)/ Rënie në inventar	(105)	291
Rënie në shpenzime të parapaguara	366	74
Rënie në tatim fitimin e parapaguar	(159)	6,966
Rënie në llogaritë e pagueshme	(5,536)	(160,342)
(Rritje)/Rënie në llogari të pagueshme të tjera	2,966	(10,354)
Fluksi i mjeteve monetare neto e gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	146,553	17,100
Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e investimit		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(23,514)	(10,162)
Fluksi i mjeteve monetare neto e gjeneruar nga veprimtaritë e investimit	123,021	6,938
Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë e financimit	-	-
Fluksi i mjeteve monetare neto e gjeneruar nga veprimtaritë e financimit	-	-
Rritje në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	123,021	6,398
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	117,808	110,871
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	240,829	117,808

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 8 deri më 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Golden Eagle Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 5 qershor 1993, bazuar në vendimin nr. 3709/1 dhe vepron sipas dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është z. Rudolf Schmid.

Veprimtaria kryesore e Shoqërisë lidhet me ndërtimin dhe ofrimin e shërbimeve ekskluzive hoteliere dhe komerciale, të cilat përfshijnë hapësirë për zyra, dyqane dhe aktivitete të lidhura me shërbimin për funksionimin e kompleksit hotelier dhe tregtar. Kapitali i regjistruar i paguar i shoqërisë është 5,650 dollarë (ekuivalent me 532,936 lekë), i ndarë në 2 kuota si më poshtë: Rogner International Hotels dhe Resorts ka 24.19% të vlerës së aksioneve dhe Rogner GmbH ka 75.81% përkatësisht 1,367 dollarë (ekuivalent me 128,917 lekë) dhe 4,283 dollarë (ekuivalent me 404,019 lekë).

Shoqëria mëmë e shoqërisë është Rogner Family, e cila ka kontrollin e shoqërisë mbi Rogner GmbH.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria kishte 147 punonjës (2017: 146 punonjës).

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), duke u bazuar në koston historike. Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi parimin e vijimësisë së biznesit, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë të operojë në periudhat në vijim.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë vlerësime dhe supozime. Drejtimi përdor gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Elementet e pasqyrave financiare që kërkojnë një nivel më të lartë të gjykimit ose subjektivitetit dhe për të cilat supozimet dhe gjykimet kanë një ndikim më të lartë, shpjegohen në shënimin 3.12.

Shumat janë shprehur në monedhën vendase lekë, përveçse kur shprehet ndryshe.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

3.1 Prezantimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të koston historike.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në lekë, që është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj janë të matura me koston historike, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet ose humbjet që kanë rezultuar nga këto transaksione njihen në pasqyrën e performancës financiare.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.3 Njohja e të ardhurave

i. Të ardhura nga shitja e mallrave

Të ardhurat nga hoteli, ushqimi dhe pijet, banketet dhe shërbime të tjera njihen si të ardhura të shtyra, derisa shërbimet ndodhin. Asnjë qera e kushtëzuar nuk njihet si e ardhur.

Të ardhurat nga qiraja njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së qirasë.

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin dhënien e shërbimeve mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, të ardhurat e lidhura me transaksionin njihen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit.

ii. Shërbimet

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve njihen në pasqyrën financiare të fitimit ose humbjes duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Aktivet Afatgjata materiale maten me kosto historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Shpenzimet shtesë do të kapitalizohen në qoftë se do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen dhe shuma e tyre mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera të mirëmbajtjes dhe riparimit njihen në fitim ose humbje në kohën kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

Kategoritë e aktiveve	Metoda	Përqindja / vit
Ndërtesa	Vlerës së mbetur	5%
Pajisje zyre	Vlerës së mbetur	20% deri 25%
Mjete Transporti	Vlerës së mbetur	20%

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël neto zhvlerësohet në vlerën e rikuperueshme nëse e tejkalon vlerën e mbetur. Fitimi ose humbja neto që rrjedh nga shitja e një aktivi afatgjatë material njihet në zërin "Të ardhura të tjera operative" në pasqyrën e performancës.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria të cilat kanë një jetë të dobishme të përcaktuar, janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kosto shtesë

Kostot shtesë do të kapitalizohen në qoftë se do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera, përfshirë shpenzime për emrin e mirë dhe të markave të prodhuara njihen në pasqyrën e performancës, kur këto shpenzime ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e software-ve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet duke përdorur amortizimin linear mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitet afatgjatë material që nga data e vënies në përdorim. Kostot e software-ve të njohura si aktiv do të amortizohen mbi vlerësimin e jetës së dobishme, e cila nuk është më shumë se katër vjet. Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Fitimet dhe humjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një aktivi jo material maten si diferencë midis të ardhurës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël neto të aktivitet dhe njihen si fitime ose humbje.

Për të vlerësuar humbjen Shoqëria përcakton grupin më të vogël të aktiveve të cilat gjenerojnë dalje të identifikueshme të fluksit të mjeteve monetare (njësia gjeneruese e mjeteve monetare). Si rezultat, disa aktive vlerësohen për humbjen individualisht dhe disa aktive të tjera përfshihen në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare.

3.6 Pagesat e qerasë

Pagesat e bëra për qira operative njihen dhe regjistrohen në pasqyrën performancës e mbi një bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë. Incentiva për qiratë zakonisht njihen si pjesë përbërëse e pagesës totale të qerasë mbi termat e qirasë.

3.7 Inventari

Inventari matet me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përfshin të gjitha kostot e blerjes dhe kostot e tjera të ndodhura gjatë sjelljes së inventarit në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale, duke përfshirë dhe koston e vulës së blerë nga Dogana e Shqipërisë lidhur me akcizën e produktit. Vlera neto e realizueshme është vlerësuar me çmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

Inventari njihet fillimisht me kosto historike dhe në vijim vlerësohet me më të voglën mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes për njësi i zvogëluar me kostot e ndryshueshme të shitjes.

3.8 Aktivitet financiar

Instrumentat financiarë të Shoqërisë gjatë 2018 përbëhen vetëm nga instrumenta financiarë joderivative: hua dhe të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre (ku përfshihen depozitat bankare të mbajtura deri në maturim), dhe të pagueshme të tjera. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar, në varësi të klasifikimit të tyre.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.8 Aktivet financiare (vazhdim)

Njohja

Shoqëria fillimisht njeh të arkëtueshmet financiare, depozitat dhe llogaritë e investimeve në datën në të cilën janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregimit, në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Matja e mëvonshme

Matja e mëvonshme e të gjitha aktiveve financiare të njohura kërkon që të maten me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë. Një matje e tillë e mëvonshme është e zbatueshme për të gjitha aktivet dhe/ose detyrimet financiare. Në mënyrë të veçantë, për investimet e borxhit që mbahen brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, dhe që kanë flukse monetare kontraktuale që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi principalin e papaguar, janë përgjithësisht të matura me koston e amortizuar në fund të periudhave kontabël.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogari rrjedhëse të mbajtura me kosto. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua dhe llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjen nga rënia në vlerë. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontojnë.

Hua dhe llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen me vlerën e tyre të amortizuar.

(i) Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë patur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivit. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi bazë individuale. Aktivet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen si fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivist me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

(ii) Çregjistrimi

Aktivtë financiare nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare të Shoqërisë nga aktivet financiare, mbarojnë ose Shoqëria i transferon aktivet financiare një pale tjetër pa ruajtur kontrollin ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë përfundojnë ose shkarkohen ose anulohen.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.8 Aktivet financiare (vazhdim)

(iii) Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen në shumën neto të raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse aktualisht është e drejta ligjore e kërkuar për të kompensuar shumat e njohura dhe nëse nuk ka ndonjë qëllim për të vendosur në bazë neto apo për të realizuar aktivitet dhe për të shlyer detyrimin në të njëjtën kohë.

(iv) Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, të pagueshme tregtare dhe të tjera janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël për shkak të termave të shkurtër të maturitetit.

3.9 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e performancës në momentin që ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të përlllogaritura lidhur me lejen vjetore për tu paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

3.10 Tatimi i fitimit

Tatim fitimi i parapaguar

Aktivitet dhe detyrimet e të ardhurave të parapaguara për periudhën aktuale dhe të mëparshme maten me shumën që pritet të rikthehet ose të paguhet në organet tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore nga ku shumat e tatimit janë llogaritur janë ato që janë miratuar në datën e raportimit.

3.11 Provizionet, pasivet dhe aktivitet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

3.12 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhme të prekur.

3. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.12 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Në veçanti, informacionet në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e natyrës së veprimeve që Shoqëria kryen.

Parimi i Vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të supozimit të vijimësisë, e cila supozon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e saj operacionale për të ardhmen e parashikueshme. Në bazë të planit të miratuar financiar të shoqërisë për vitet e ardhshme, Shoqëria parashikohet të rrisë aktivitetin e saj operacional dhe është parashikuar një rezultat pozitiv në vitin e ardhshëm. Përveç sa më sipër, ortakët e Shoqërisë janë angazhuar për të mbështetur financiarisht Shoqërinë në rast se kjo do të jetë e nevojshme.

3.13 Dividendë

Shoqëria i njeh dividendët si detyrim në periudhën në të cilën janë deklaruar dhe në bazë të vendimeve të Asamblesë së Ortakëve.

3.14 Informacione te krahasueshme

Disa riklasifikime jane bere per te paraqitur nje ndikim me te mire te informacioneve te krahasueshme nga viti i kaluar.

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

4 Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Mjete monetare në Bankë	238,075	114,610
LEK	122,646	82,303
EUR	102,045	25,521
USD	13,384	6,786
Mjete monetare në arkë	2,754	3,198
LEK	2,208	3,045
EUR	546	153
Totali	240,829	117,808

5 Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Te linjta, uniforma, paisje kuzhine, cigare, kancelari	3,218	2,421
Ushqime	4,772	4,853
Materiale pastrimi	1,576	959
Pije	3,502	3,691
Materiale për klientët	2,870	3,909
Totali	15,938	15,833

6 Të arkëtueshme tregtare

Llogari te arketueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga aktiviteti operativ	16,663	30,112
Të arkëtueshme nga kliente qe jane ne Hotel me 31 Dhjetor	1,556	766
Totali	18,219	30,878

7 Shpenzimet e parapaguara

Shpenzimet e parapaguara më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Shpenzime të parapaguara	2,538	2,906
Totali	2,538	2,906

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018
(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

Kosto	Ndërtesa	Mobilje dhe pajisje zyre	Mjete transporti	Ndërtime në progres	Totali
Teprica më 31 dhjetor 2017	2,491,601	513,284	3,158	2,422	3,010,464
Shtesa	-	25,483	-	2,002	27,485
Pakësime	-	-	-	(1,359)	(1,359)
Teprica më 31 dhjetor 2018	2,491,601	538,766	3,158	3,065	3,036,590
Zhvlërësimi i akumuluar					
Teprica më 31 dhjetor 2017	(1,342,208)	(375,633)	(2,232)	-	(1,720,073)
Amortizimi për vitin	(57,470)	(33,641)	(185)	-	(91,295)
Teprica më 31 dhjetor 2018	(1,399,678)	(409,274)	(2,417)	-	(1,811,369)
Vlera e mbetur					
Më 31 dhjetor 2017	1,149,392	137,650	926	2,422	1,290,391
Më 31 dhjetor 2018	1,091,923	129,493	741	3,065	1,225,221

Asnjë aktiv afatgjatë material nuk është vendosur si kolateral ndaj huamarrjes nga palë të tjera më 31 dhjetor 2018. (2017: asnjë).

Ne pajisjet dhe mobiljet e zyrës më 31 dhjetor 2017 është bërë një rregullim prej 2,613 mijë lek e cila i përket një korigjimi në kontabilitet tek zhvlërësimi i akumuluar.

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

9. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Më	Më
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të pagueshme nga aktiviteti operativ	34,975	43,346
Të pagueshme per palët e lidhura	31,312	28,477
Totali	66,287	71,823

10. Të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Më	Më
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shpenzime të përlllogaritura	27,596	28,228
Shpenzime të përlllogaritura personeli	7,416	7,140
TVSH e pagueshme	3,139	2,991
Të pagueshme të tjera	6,877	958
Totali	45,028	39,317

11. Garanci Qeraje

Depozitat – Garanci per qirate më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Më 31	Më 31
	dhjetor 2018	dhjetor 2017
Garanci Qeraje	4,221	5,981
Totali	4,221	5,981

Garanci Qeraje lidhet me pagesen e mare si garanci nga klientet të cilet kane mare zyra me qira nga Golden Eagle Shpk, për te kryer aktivitetin e tyre të përditshëm.

12. Kapitali i paguar

Tabela më poshtë tregon strukturën e kapitalit të Shoqërisë për 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	Vlera e kuotave në	Vlera e kuotave në	Kuotat në %
	USD	lekë	
Rogner GmbH	4,283	404,019	75.81
Rogner International Hotels and Resorts	1,367	128,917	24.19
Totali	5,650	532,936	100

Më 31 dhjetor 2018, kapitali i paguar i regjistruar i Shoqërisë është 5,650 dollarë (ekuivalent me 532,936 lekë), i ndarë në 2 kuota si vijon: Rogner International Hotels dhe Resorts me 24.19% të vlerës së aksioneve dhe Rogner GmbH me 75.81% përkatësisht 1,367 dollarë ekuivalente me 128,917 lekë) dhe 4,283 dollarë (ekuivalent me 404,019 lekë).

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

13. Të ardhurat

Të ardhurat nga shitjet më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga akomodimi	339,643	321,350
Të ardhura nga ushqimet	176,518	167,412
Të ardhura nga pijet	71,743	71,456
Të ardhura nga qeraja dhe telefonia	39,266	37,805
Të ardhura operative të tjera	38,944	31,813
Totali	666,114	629,836

Të ardhurat e tjera operative përfshijnë të ardhurat e krijuara nga aktivitete të tjera të tilla si: dhenia me qira (orare, ditore, disa ditore) e sallave të konferencave, shitja e cigareve, fusha e tenisit, pishina, shërbim lavanterie për klientet etj..

14. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të tjera	4,865	4,558
Totali	4,865	4,558

Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhurat e krijuara nga shitjet të linjtave dhe dëmshpërblimeve nga kompanitë e sigurimeve, komisione etj.

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

15. Ndryshimet në gjëndjen e inventarit

Ndryshimet në inventar më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e ushqimeve	44,438	42,588
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e pijeve	15,058	14,083
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e duhanit	1,998	2,059
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e materilave për klientët	9,955	9,829
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e produkteve që shiten në bar	483	1,628
Ndryshime në gjëndjen / ineqnatrin e uniformave	2,293	1,602
Ndryshime në gjëndjen / inventarin e të linjtave	2,180	1,368
Ndryshime në artikujt e pastrimit dhe të mirëmbajtjes	6,903	5,859
Ndryshime të tjera inventari	7,178	6,111
Total	90,486	85,127

16. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen nga paga dhe kontributet të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzimet e pagës	145,103	130,804
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore	16,143	15,392
Totali	161,246	146,196

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

17. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për Energji elektrike	32,388	32,796
Shpenzime për pastrimin e të linjtave	22,902	20,937
Shpenzime për taksen mbi infrastrukturen	21,939	2,369
Shpenzime për komisione për agjentet e udhëtimit	17,150	11,112
Taksa për ndërtesën	9,472	6,211
Shpenzime telekomunikacioni	5,654	5,742
Shpenzime sigurie	4,459	4,440
Shpenzime uji dhe kanalizimesh	4,316	3,528
Shpenzime për muzikë dhe argëtimin e klienteve	3,388	2,898
Shpenzime Mirëmbajtje; mobilie	3,380	7,699
Shpenzime Mirëmbajtje; paisje kompjuterike dhe telefoni	3,125	2,678
Shpenzime sigurimi	3,015	2,790
Shpenzime per Lule dhe Dekoracione	2,676	2,347
Evente special	2,446	989
Shpenzime Mirëmbajtje; ndërtesa	2,240	2,428
Shpenzime këshillimi financiar & auditimi	2,188	3,167
Shpenzime per Qira Toke	2,186	2,663
Shpenzime Miëmbajtje;dysHEME dhe shtresae mureve	2,035	101
Shpenzime reklamash	1,614	2,847
Shpenzime trajnimi	1,557	194
Shpenzime per Materiale te printuara	1,519	1,678
Shpenzime Mirëmbajtje; hidraulike	1,408	2,656
Shpenzime udhëtimi	1,311	1,268
Shpenzime karburanti	1,302	1,205
Shpenzime Mirëmbajtje; paisje elektrike	1,205	1,454
Shpenzime Mirëmbajtje; lysterje	1,205	1,598
Shpenzime Mirëmbajtje; ashensore	949	280
Shpenzime utilitare (Gazeta, Revista etj)	893	933
Shpenzime rezervimi	898	7,769
Shpenzime për shërbime kontraktuale	833	1,639
Shpenzime per heqje mbeturinash dhe Desinfektme	610	-
Shpenzime Mirëmbajtje; kopshti dhe hapsira përreth	562	1,075
Shpenzime Mirëmbajtje; automjete	480	239
Shpenzime Mirëmbajtje; makineris dhe pajisje	446	2,214
Shpenzime postare	343	340
Shpenzime per furnizime qe i ofrohen klienteve pa pagese	333	678
Shpenzime Mirëmbajtje;frigorifere dhe kondicionerë	331	398
Shpenzime Mirëmbajtje; siguria ne pune dhe e jetës	195	203
Shpenzime të tjera marketingu	376	3,420
Shpenzime të tjera mirëmbajtjeje	192	23
Totali	163,521	147,006

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

17. Shpenzimet operative (vazhdim)

Shpenzime të tjera marketingu dhe promocioni janë të lidhura me shërbimet fotografike gjatë eventeve të ndryshme si edhe me kuotat e anetaresimit në dhomat e tregetisë.

18. Tarifat e menaxhimit

Shpenzimet për tarifat e menaxhimit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	For the year ended December 31, 2018	For the year ended December 31, 2017
Tarifa menaxhimi	41,184	39,869
Tarifa marketing	13,673	12,808
Tarifa profesionale	11,457	9,961
Tarife honorari	10,255	9,606
Totali	76,569	72,244

19. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fatura e TVSH-se për ushqimin e stafit dhe përfaqësim	13,162	13,915
Shpenzime për humbje nga Llogarite e Arketueshme	2,080	728
Shpenzime nga TVSH e pa kreditueshme	1,967	1,962
Shpenzime Banketesh	1,296	1,077
Shpenzime të tjera	1,078	599
Shpenzime për te Drejtat e Autorit	438	644
Shpenzime Ligjore (Perkthime & Noterime)	74	205
Shpenzime për Agjensi Doganore	47	122
Shpenzime për programe TV	13	19
Shpenzime për taksë doganore	11	-
Totali	20,166	19,270

20. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime financiare neto	(7,750)	7,726
Fitim neto nga kursi i këmbimit	449	(3,305)
Totali	(7,301)	4,421

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

21. Shpenzimi i tatim fitimit

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi mbi fitimin fiskal për vitin financiar 2018. Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptarë. Norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

	2018	2017
Fitimi para tatimit	62,264	64,794
Shpenzimet e pazbritshme	22,632	19,631
Fitimi fiskal për vitin	84,897	84,425
Tatim mbi fitimin në 15%	12,735	12,664

Shpenzimet e pazbritshme nga ligji fiskal kanë pasur një rritje në krahasim me vitin paraardhës, kryesisht nga rritja e shpezimeve të përlllogaritura.

Kthimet tatimore paraqiten çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten të përkohshme derisa autoritetet tatimore të shqyrtojnë kthimet dhe të dhënat e tatimpaguesit dhe të lëshohet një vlerësim përfundimtar. Ligjet dhe rregulloret tatimore janë subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore

22. Palët e lidhura

Në rrjedhën e kryerjes së veprimtarisë operacionale, Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme më palët e lidhura. Palët e lidhura përfshijnë entitete “Rogner International Hotels and Resorts”, “SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.”, “Rogner Holding GmbH” and “Rogner GmbH”.

Për periudhën e mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, kanë ndodhur transaksionet me palët e lidhura si më poshtë:

	Me 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
<i>Pozicioni financiar</i>		
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
Rogner International Holtels and Resorts	-	136
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	-	-
Rogner Holding GmbH	-	-
Rogner GmbH	-	-
Totali	-	136
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Rogner International Holtels and Resorts	(25,754)	(24,057)
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	(3,530)	(4,027)
Rogner Holding GmbH	(1,345)	(93)
Rogner GmbH	(684)	(300)
Totali	(31,313)	(28,477)

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

22. Palët e lidhura (vazhdim)

<i>Performanca financiare</i>	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga palët e lidhura		
Rogner International Holtels and Resorts	-	-
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	-	1,090
Rogner Holding GmbH	-	-
Rogner GmbH	-	-
Totali	-	1,090
		-
Blerje nga palët e lidhura		
Rogner International Holtels and Resorts	(57,461)	(55,388)
SPA Therme Blumau Betriebs GmbH.	(28,047)	(28,548)
Rogner Holding GmbH	(15,709)	(16,023)
Rogner GmbH	(3,073)	(611)
Totali	(104,290)	(100,570)

Kompensimi i Menaxhimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Paga	5,352	4,149
Taksa	313	444
Totali	5,665	4,593

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

23. Angazhime dhe garanci

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, Shoqëria mund të jetë e përfshirë në pretendime ligjore ose veprime të palëve të treta. Në bazë të mendimit të Drejtimit të shoqërisë, përfundimi final në lidhje me këto çështje nuk do të ketë një efekt mbi pozicionin financiar të shoqërisë, ose nuk do të sjellë ndryshime në aktive.

Shoqëria është në proces ligjor me Terenzio D'Allenën për rikthimin e tokës. Çështja është në pritje të seancës dëgjimore të gjykatës së lartë. Deri në datën e këtij raporti të auditimit nuk ka informacione të mëtejshme lidhur me rastin e lartpërmendur. Drejtimi do të mbrojë fuqishëm çështjen dhe vlerëson se vendimi do të jete në favor të Golden Eagle Shpk

24. Menaxhimi i rrezikut financiar

Menaxhimi i rrezikut është një element thelbësor në aktivitetet e shoqërisë. Rreziqet më të mëdha me të cilat Shoqëria përballlet janë ato që lidhen me rrezikun e tregut (duke përfshirë çmimin, normën e interesit dhe rrezikun e monedhës), riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit.

(i) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria mban aktivet dhe detyrimet të shprehura në euro dhe dollar. Rreziku i kursit të këmbimit është i pranishëm kur aktivet aktuale ose të parashikuara në monedhë të huaj janë më pak ose më shumë se detyrimet në këtë monedhë. Ndikimi i rrezikut të kursit të këmbimit të shoqërisë është i kufizuar pasi transaksionet në monedhat në lekë, në dollar dhe në euro janë të kufizuara.

Ekspozimi i Shoqërisë me kursin e këmbimit në 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2018	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	LEK
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	240,829	102,591	13,384	124,854
Llogari të arkëtueshme	18,219	-	-	18,219
Të tjera të arkëtueshme	2,539	965	1,355	219
Totali i aktiveve financiare	261,587	103,556	14,739	143,292

Më 31 dhjetor 2018	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	LEK
Llogari të pagueshme	(34,975)	(18,809)	(144)	(16,022)
Të pagueshme me palët e lidhura	(31,312)	(31,312)	-	-
Të pagueshme të tjera	(45,028)	-	-	(45,028)
Totali i detyrimeve financiare	(111,315)	(50,121)	(144)	(61,050)
Pozicioni neto i kursit të këmbimit	150,272	53,435	14,595	82,242

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

24. Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2017	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	LEK
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	117,808	25,674	6,786	85,348
Llogari të arkëtueshme	30,878	-	-	30,878
Të tjera të arkëtueshme	2,906	1,009	775	1,122
Totali i aktiveve financiare	151,592	26,683	7,561	117,348

Më 31 dhjetor 2017	Vlera kontabël (neto)	EUR	USD	LEK
Llogari të pagueshme	(43,346)	(15,901)	(76)	(27,369)
Hua nga ortakët	(28,477)	(28,477)	-	-
Të pagueshme të tjera	(39,317)	-	-	(39,317)
Totali i detyrimeve financiare	(111,140)	(44,378)	(76)	(66,686)
Pozicioni neto i kursit të këmbimit	40,452	(17,695)	7,485	50,662

Më poshtë janë kurset e këmbimit të aplikuar gjatë vitit:

	Kursi i këmbimit mesatar		Kursi i këmbimit në datën raportuese	
	2018	2017	2018	2017
EUR	127.59	134.15	123.42	132.95

Analiza e ndjeshmërisë së valutës së huaj

Analiza e ndjeshmërisë më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit dhe ndryshimi i përcaktuar që ndodh në fillim të vitit financiar dhe është mbajtur konstant gjatë gjithë periudhës raportuese. Më poshtë është një përcaktim i efekteve të ndryshimeve në kursin e këmbimit në fitimin neto, duke supozuar se të gjitha variablat e tjerë mbahen konstant:

	Më 31 dhjetor 2018	Më 31 dhjetor 2017
Euro appreciates by 10%	5,344,500	(1,760,200)
Euro depreciates by 10%	(5,344,500)	1,760,200

(ii) *Rreziku tatimor*

Legjislacioni tatimor shqiptar është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshimet që ndodhin shpesh. Si rezultat, transaksionet mund të sfidohet nga organet tatimore dhe Shoqëria mund të vlerësojë taksa shtesë, gjopa dhe interesa, të cilat mund të jenë të rëndësishme. Periudhat mbeten të hapura për t'u shqyrtuar nga organet tatimore dhe doganore në lidhje me detyrimet tatimore për pesë vjet. Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të asnjë rrethane, të cilat mund të sjellin një detyrim të mundshëm material në këtë drejtim.

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

24. Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

(iii) Rreziku i likuiditetit

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, struktura e maturimit të detyrimeve financiare të Shoqërisë bazuar në pagesat e paskontuara është paraqitur si më poshtë:

Manaxhimi i rrezikut financiar	<i>(LEK)</i>	<i>(LEK)</i>	<i>(LEK)</i>	<i>(LEK)</i>
31 dhjetor 2018	< 3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Totali
Të pagueshme tregëtare	(34,975)	-	-	(34,975)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(31,312)	-	-	(31,313)
Të pagueshme të tjera	(45,028)	-	-	(45,028)
Totali	(111,315)	-	-	(111,315)
31 dhjetor 2017				
Të pagueshme tregëtare	(17,593)	(25,753)	-	(43,346)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(28,477)	-	-	(28,477)
Të pagueshme të tjera	(39,317)	-	-	(39,317)
Totali	(85,387)	(25,753)	-	(111,140)

GOLDEN EAGLE SHPK
Shënime mbi pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK)

24. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku kreditor

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, struktura e maturimit të llogarive të arkëtueshme të Shoqërisë bazuar në pagesat e paaktualizuara është si më poshtë:

Manaxhimit i rrezikut financiar	<i>(LEK)</i>	<i>(LEK)</i>	<i>(LEK)</i>	<i>(LEK)</i>	<i>(LEK)</i>
	< 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	> 12 muaj	Totali
31 dhjetor 2018					
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	239,501	-	-	1,328	240,829
Të arkëtueshme tregëtare	18,219	-	-	-	18,219
Të arkëtueshme të tjera	1,291	-	1,248	-	2,539
Totali	259,011	-	1,248	1,328	261,587
31 dhjetor 2017					
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	116,480	-	-	1,328	117,808
Të arkëtueshme tregëtare	16,124	8,873	5,880	-	30,877
Të arkëtueshme të tjera	1,009	1,122	775	-	2,906
Totali	133,613	9,995	6,656	1,328	151,591

25. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit, të cilat kërkojnë ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.